



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/2010), Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Rregullores (QRK) nr. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, MASHTI, shpall:

KONKURS

Për vendet e lira të punës në Qendrat Burimore

Nr.	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	<i>Roje në QB “Nënë Tereza” në Prizren rishpallje</i>	Kohë të pacaktuar	1
2	<i>Punëtor/e teknik/e në QB “Lef Nosi” në Prizren – shpallje</i>	Kohë të pacaktuar	1
3	<i>Vozitës në QB “Lef Nosi” në Prizren rishpallje</i>	Kohë të pacaktuar	1

I . Punët dhe detyrat e rojës

- Ruan dhe kujdeset për sigurinë e hapësirës së Qendrës Burimore;
- Kontrollon hyrjet dhe daljet në objektet e Qendrës Burimore dhe mban evidenca lidhur me këtë;
- Gjatë orarit të punës i kontrollon të gjitha hapësirat e Qendrës Burimore dhe evidenton të gjitha parregullsitë në librin e kujdestarisë;
- Gjatë orarit të punës i kontrollon të gjitha hapësirat e Qendrës Burimore dhe kujdeset që mos të shkaktohet zjarr, vërshime apo plaçkitje;
- Në rast fatkeqësie natyrore është i obliguar t’u jep ndihmë nxënësve;
- Kryen dhe punë tjera që i cakton drejtori.

1. Përgatitja shkollore për roje

- Arsimi i mesëm.

II. Punët dhe detyrat kryesore të punës për punëtor/e teknik/e

- Kujdeset për meremetime të ndryshme në objektin e shkollës;
- Bën riparimin e dymve, dritareve, dyshemesë, inventarit në Qendër Burimore dhe konvikt, si dhe në hapësirat përcjellëse të Qendrës Burimore;
- Mirëmban ngrohjen qendrore dhe kujdeset për funksionimin e saj (në kohën kur aktivizohet, ngrohja qendrore duhet të dalë dy orë më herët në punë për të bërë ndezjen e ngrohjes);
- Është përgjegjës për punëtorinë e shkollës;
- Mban evidencë dhe raporton te drejtori i QB për riparimet e bëra;
- Kryen edhe punë tjera që i cakton drejtori (sipas nevojës mund të caktohet orari i punës të ndarë në dy pjesë).

2. Përgatitja shkollore për punëtor/e teknik/e

- Arsimi i mesëm.

III. Punët dhe detyrat kryesore të punës për vozitës

- Është përgjegjës për automjetet e Qendrës Burimore;
- Mirëmban automjetet e Qendrës Burimore;
- Kujdeset për servisimin e automjeteve të Qendrës Burimore;
- Është përgjegjës për regjistrimi e automjeteve të Qendrës Burimore;
- Vozit automjetet e qendrës/shkollës dhe transporton nxënësit në relacionet shtëpi- shkollë dhe anasjelltas;
- Mban përgjegjësi për fëmijët gjatë transportit të tyre në relacionet shtëpi- shkollë dhe anasjelltas;
- Të jetë bashkëpunues me prindër.

3. Përgatitja shkollore për vozitës

- Arsimi i mesëm.

Kushtet e konkursit

Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente;

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI;

Përparësi në konkurs kanë kandidatët që ofrojnë diploma/certifikata për aftësi profesionale që korrespondojnë me vendin e punës në të cilin konkurrojnë;

Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit;

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës;

Kandidatët që aplikojnë për pozitën vozitës duhet të kenë patentë shoferi të kategorisë D;

Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj);

Koeficienti për vozitës 3.86, ndërsa për punëtor/e teknik/e dhe roje 3.76.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik;
Formulari i aplikimit (merret në Qendrën Burimore ku është konkursi);
Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
Diploma e kualifikimit duhet të jetë e noterizuar;
Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore përkatëse ku konkurrojnë;
Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.